

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 11.05.2016]

Për: Operatorin Ekonomik “Hastoci” shpk.

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Rikonstruksion i rruges autostrade - fshati Bulo”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i rruges autostrade - fshati Bulo”**.

Kohëzgjatja: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës, me përfundim brënda 8 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: **72.011.026 (shtatedhjetë e dy milion e njembedhjetë mijë e njetzet e gjashtë)** lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 15.03.2016.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH
1	NIKA	42,818,308
2	COMPANY RIVIERA 2008	45,083,390
3	"SHKELQIMI 07"	49,920,360
4	CAUSHI	50,059,620
5	HASTOÇI	50,297,270
6	KALIVIOTI	50,396,385
7	MANE/S	51,195,650
8	COBIAL	52,498,820
9	B-93	56,688,990
10	ALBA KONSTRUKSION	57,974,630
11	CURRI	60,400,565
12	DENIS-05	61,805,940
13	ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCION	62,379,700
14	ROSI	67,057,500
15	SENKA/L	NUK KA PARAQITUR OFERTE

Komisioni vendosi te mblidhet pasi te gjithë antaret, ne menyre individuale, te shqyrtojne dokumentat per kualifikim te paraqitur nga shoqeria.

Ne daten 06.04.2016 Komisioni I Vleresimit te Ofertave vazhdoi me proceduren e vleresimit te ofertave te operatoreve ekonomike pjesemarres.

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Nika” shpk (30,3%) dhe “Elkri” shpk (69,7%) per arsye se:

Shoqeria “Elkri” shpk nuk ploteson piken 2.1.dh te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur deklaraten mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9.

Shoqeria “Elkri” shpk nuk ploteson piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”*. Shoqeria “Elkri” shpk, si shoqeria me perqindjen me te madhe ne bashkim, bazuar ne nenin 74, pika 3 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duhet te paraqese dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme, te kryera ne tre vitet e fundit, me vlere jo me pak se 36.005.513 leke pa tvsh ose te shume puneve, te kryer ne tre vitet e fundit, me vlere jo me pak se 96.494.774 leke pa tvsh.*

Per te provuar plotesimin e ketij kushti shoqeria “Elkri” shpk ka paraqitur dy pune: *“Rikonstruksion qender Markat” me vlere 30.997.650 leke pa tvsh e cila nuk ploteson kerkesen si pune e vetme (pasi duhet te jete jo me pak se 36.005.513 leke pa tvsh) dhe “Sistemim asfaltim rruga nga kufiri Dhermadhes deri tek stacioni Sopikut” e cila, sipas dokumentacionit te paraqitur, ka filluar ne daten 03.12.2008 dhe ka perfunduar ne daten 20.12.2010, pra jashte tre viteve te fundit.*

Shoqeria “Elkri” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete...”* pasi kontrata e lidhur me inxhinierin hidroteknik Kristaq Kali ka perfunduar ne daten 23.11.2015, pra nuk eshte me e vlefshme.

Shoqeria “Elkri” shpk nuk ploteson piken 2.4.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret e kerkuar ne piken 2.4.3 per kualifikim jane te pa angazhuar ne kontrata te tjera”* pasi nuk e ka paraqitur kete deklarate.

Shoqeria “Elkri” shpk nuk ploteson piken 2.4.7 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera”* pasi nuk e ka paraqitur deklaraten e kerkuar.

Shoqeria “Elkri” shpk nuk ploteson piken 2.4.6 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik...”* pasi ka marre persiper te kryeje te gjithë punimet per shtresat rrugore nderkohe qe nuk disponon makinerite e nevojshme per kete qellim: Gurëthyes, frontoje – 1 copë, Fabrikë asfaltobetoni – 1 copë, Autobitumatriçe – 1 copë, Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton) – 1 copë dhe Rrul asfalti me goma (kapaciteti jo me pak se 8 ton) – 1 copë.

Gjithashtu per ekskavatorin me goma me numer shasie 28613 nuk ka paraqitur lejen e qarkullimit, sic eshte kerkuar ne kerkesen per kualifikim. Ky lloj mjete shenohet ne regjistrat publike dhe per

kete lloj mjeti eshte kerkuar te paraqiten *dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe fotot e mjeteve.*

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Company Riviera 2008” shpk (89,5%) dhe “Kevin Konstruksion” shpk (10,5%) per arsye se:

Shoqeria “Company Riviera 2008” shpk nuk ploteson piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”* pasi faturat e paraqitura per punet e ngjashme jane te palexueshme. Per kete pike komisioni u mbeshtet ne Vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik Nr 1868 date 11.12.2015.

Shoqeria “Company Riviera 2008” shpk nuk ploteson piken 2.4.6 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve teknike pasi per fabriken e asfaltbetonit qe ka deklaruar ne tender nuk ka paraqitur lejen mjedisore leshuar nga QKL ne perputhje me kerkesen per kualifikim.

Shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.1.dh te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur deklaraten mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9.

Shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.4.6 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve teknike pasi ka mare persiper te kryeje punimet e meposhtme: shtrese stabilizanti 10cm perhapur + ngjeshur makineri 14.200 m2, shtrese cakelli 10cm perhapur + ngjeshur makineri 18.000 m2 dhe bankina anesore me cakull natyror 722 m3, por ka deklaruar se disponon vetem nje kamion i cili eshte i pamjaftueshem pasi mungojne mjetet ngjeshes.

Te skualifikoje shoqerine “Shkelqimi-07” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.1 ”e” te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri pasi, bazuar ne vertetimin qe ka paraqitur, eshte debitor ne shumen 656.621 leke dhe per kete fakt eshte ne proces ankimimi. Bazuar ne nenin 26, pika 7, germa “c” te VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet: *“Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë”*, duke qene se vertetimi nuk konfirmon ankimimin ne gjykate, shoqeria duhet te skualifikohet.

Nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet”* pasi nuk ka paraqitur dokument per shlyerjen e detyrimeve per taksat vendore ne Tirane, ku ushtron aktivitet bazuar ne ekstraktin e QKR. Per te vertetuar pagesen e taksave vendore ne Tirane ka paraqitur nje urdher cbllokimi qe Bashkia Tirane ju dergon disa bankave, por ky urdher nuk provon se taksat dhe tarifafat vendore ne Tirane jane paguar.

Nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “*Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...*” pasi per inxhinierin mekanik Ilirian Lloshi nuk ka paraqitur diplomen, ne kundershtim me kerkesen per kualifikim.

Nuk ploteson piken 2.4.6 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve teknike pasi fabrika e asfaltobetonit qe ka deklaruar ne tender ndodhet ne rruget nacionale Fier – Patos, km 1, fshati Portez, Qarku Fier, (bazuar ne lejen mjedisore leshuar nga QKL). Ne kete menyre nuk ploteson kerkesen qe distanca nga objekti te mos jete me e madhe se 70 km pasi distanca faktikisht eshte rreth 117 km.

Nuk ploteson piken 2.4.8 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me disponimin e certifikatave iso pasi nga verifikimi ne sistem nuk rezulton qe certifikata ISO 39001:2012 te jete leshuar nga Quality Certification Bureau Italia, si dhe certifikata ISO 14001:20014 rezulton me statusin “suspended” sipas printscreen-it perkates ne procesverbal.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Caushi” shpk (88%) dhe “Sinder AB” shpk (12%) per arsye se:

Shoqeria “Caushi” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “*Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...*” pasi per inxhinierin topograf Zylfi Gashi nuk ka paraqitur diplomen, ne kundershtim me kerkesen per kualifikim.

Shoqeria “Caushi” shpk nuk ploteson piken 2.4.8 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “*Operatori Ekonomik duhet te disponoje certifikatat:*

ISO 9001:2008

ISO 14001:2004

OHSAS 18001:2007

ISO 39001:2012

Certifikatat kerkohet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit” pasi certifikatat ISO 9001:2008 dhe ISO 39001:2012 jane ne emer te “Caushi/M” dhe jo te “Caushi”.

Shoqeria “Sinder AB” shpk nuk ploteson piken 1.a te Kerkesave te Pergjithshme per Kualifikim “*Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*” pasi nuk ka paraqitur Ekstraktin e Regjistrat Tregtar për të Dhënat e Subjektit.

Shoqeria “Sinder AB” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “*Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...*” pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per punesimin e nje inxhinieri hidroteknik, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punimet per kanalizimet e ujrave te bardhe dhe punimet per ndertimin e tombinove per te cilat ky inxhinier eshte i domosdoshem.

Shoqeria “Sinder AB” shpk nuk ploteson piken 2.4.6 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve teknike pasi per ekskavatorin me goma me numer shasie 162M22564 nuk ka paraqitur lejen e qarkullimit, sic eshte kerkuar ne kerkesen per kualifikim. Ky lloj mjeti shenohet ne regjistrat publike dhe per kete lloj mjeti eshte kerkuar te paraqiten *dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe fotot e mjeteve.*

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Kalivioti” shpk (33%) dhe “Jody-Kompany” shpk (67%) per arsye se:

Shoqeria ”Kalivioti” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...” pasi nuk ka paraqitur diplomen per inxhinierin hidroteknik, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punimet per kanalizimet e ujrave te bardhe per te cilat ky inxhinier eshte i domosdoshem.

Shoqeria ”Jody-Kompany” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me gjendjen ne banke, pasi disponon ne banke nje shume prej 4.000.000 leke, nderkohe qe sipas perqindjes se puneve qe ka mare persiper duhet te dispononte 4.824.739 leke.

Shoqeria ”Jody-Kompany” shpk nuk ploteson piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit” pasi per punet e deklaruar nuk ka paraqitur faturat tatimore te kerkuara ne kerkesen per kualifikim.

Shoqeria ”Jody-Kompany” shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt...” pasi per inxhinierin mekanik Kristofor Lapa nuk ka paraqitur cv, per inxhinierin topograf Jorgo Papa nuk ka paraqitur diplomen dhe cv, nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per inxhinierin hidroteknik, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punimet per kanalizimet e ujrave te bardhe per te cilat ky inxhinier eshte i domosdoshem.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Mane/S” shpk (82.2%) dhe “Iliria/D” shpk (17.8%) per arsye se:

Shoqeria ”Mane/S” shpk nuk ploteson piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”. Shoqeria “Mane/S” shpk, si shoqeria me perqindjen me te madhe ne bashkim, bazuar ne nenin 74, pika 3 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duhet te paraqese dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme, te kryera ne tre vitet e fundit, me vlere jo me pak se 36.005.513 leke pa tvsh ose te shume puneve, te kryer ne tre vitet e fundit, me vlere jo me pak se 118.386.127 leke pa tvsh. Per te provuar plotesimin e ketij kushti kjo shoqeri ka paraqitur 11 pune te listuara ne procesverbalin perkates.

Duke qene se me dokumentacionin e paraqitur kjo shoqeri nuk ploteson kerkesen per kualifikim si me nje pune te vetme (pasi puna me e madhe e deklaruar ka vleren 26.564.295 leke nga 36.005.513 leke qe eshte kerkesa) ashtu edhe me shume pune (pasi vlera totale e puneve te deklaruar ne tre vitet e fundit eshte 102.484.761 leke nga 118.386.127 leke qe eshte kerkesa) komisioni gjykon se ky kusht nuk plotesohet.

Shoqeria "Mane/S" shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim "Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt..." pasi per inxhinierin e ndertimit Malo Mane nuk ka paraqitur diplomen. Ne kete menyre kjo shoqeri nuk e ploteson kete kerkese.

Shoqeria "Mane/S" shpk nuk ploteson piken 2.4.6 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve teknike pasi per ekskavatorin me goma me numer shasie 233241936ME nuk ka paraqitur lejen e qarkullimit, sic eshte kerkuar ne kerkesen per kualifikim. Ky lloj mjeti shenohet ne regjistrat publike dhe per kete lloj mjeti eshte kerkuar te paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe fotot e mjeteve.

Shoqeria "Iliria/D" shpk nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim "Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt..." pasi per inxhinierin e topograf Napolon Vogli nuk ka paraqitur diplomen, nuk ka paraqitur dokumentacion per ing mekanik nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punimet per riparimin e ures beli, nuk ka paraqitur dokumentacion per ing hidroteknik nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punimet per kanalizimin e ujrave te bardha. Ne kete menyre kjo shoqeri nuk e ploteson kete kerkese.

Shoqeria "Iliria/D" shpk nuk ploteson piken 2.4.7 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim "Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera" pasi nuk e ka paraqitur deklaratën e kerkuar.

Te skualifikoje shoqerine "Alba Konstruksion" shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.4.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim "Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt..." pasi:

- Mungon diploma e inxhinieres elektrike Katerina Dhoska. Ne vend te saj eshte paraqitur nje diplome e ing. Luljeta Thomaj dhe nuk eshte paraqitur asnje dokument qe te provoje se eshte i njejti person.
- Drejtuesit teknike Merkur Kamo (inxhinier hidroteknik), Katerina Dhoska (inxhinier elektrike), Xhemil Gurabardhi (inxhinier mekanik) dhe Najada Jarazi (inxhinier mjedisi) jane te punesuar part time ne kete shoqeri me vetem 32 ore ne muaj. Po ashtu drejtuesi teknik Bajram Cika (inxhinier gjeolog) eshte i punesuar part time ne kete shoqeri (vetem 12 ore ne muaj). Kjo gje deshmohe jo vetem nga kontratat e punes, por edhe nga listepagesat e shoqerise. Ky fakt eshte ne kundërshtim me Kreun IV "Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë", pika 2 "Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit", te VKM Nr.42, datë 16.1.2008 "**Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi**" ku nder te tjera citohet: "Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit". Fakti qe drejtuesit teknike nuk mund te jene te punesuar part time gjen mbeshtetje edhe ne Kreun III, pika 3, germa "c" te VKM

Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” ku ndër të tjera citohet: “Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Te skualifikoje shoqerine “Senka/L” shpk per arsye se nuk ka paraqitur oferte.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “Hastoci” shpk** se oferta e paraqitur, me vlerë **50.297.270 (pesedhete milion e dyqind e nentedhjetë e shtate mijë e dyqind e shtatëdhjetë)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **06.04.2016**.

Per vleresimin ne daten 11.04.2016 paraqiti ankim bashkimi i shoqerive “Mane/S” shpk & “Iliria/D” shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 13.04.2016 duke e refuzuar ate.

Ne daten 13.04.2016 paraqiti ankim shoqeria “Nika” shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 14.04.2016 duke e refuzuar ate.

Ne daten 13.04.2016 paraqiti ankim shoqeria “Riviera-2008” shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 14.04.2016 duke e refuzuar ate.

Ne daten 14.04.2016 u be rivleresimi ne sistem per te korigjuar arsyet e skualifikimit per shoqerite “Mane/S” shpk & “Iliria/D” shpk dhe “Nika” shpk & “Elkri” shpk.

Ne daten 15.04.2016 paraqiti ankim shoqeria “Kalivioti” shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 15.04.2016 duke e refuzuar ate.

Ne daten 22.04.2016 shoqeria “Riviera-2008” shpk paraqiti ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik.

Me vendimin nr. 991 date 10.05.2016 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

“Të pushojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. Ref 24493-02-18-2016 me objekt “Rikonstruksion i rruges autostrade - fshati Bulo” me fond limit 72,011,026 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.03.2016, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit”.

Ankesa te tjera nuk ka patur.

